



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 616, datë 10.12.2020

PËR
EMËRIMIN E PËRKOHSHËM TË Z. {...}, NË POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR
NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 1, shkronja “c” dhe nenin 97, pika 1 shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 55, 56, 57, 58 dhe 59 të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” dhe nr. 586, datë 20.11.2020 “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmës ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet përkatëse të kandidatëve për ndihmës ligjorë në Gjykatat e Apelit, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR